



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 52, datë 31.05.2022

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR VITIN 2022 ME VLERË 100'000'000 (NJËQIND MILION) LEKË PA TVSH, NË ZBATIM TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.291, DATË 11.5.2022 "PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.201, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTEA (PALLAT) NË BASHKITË DURRËS DHE KAMZË"

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 11.5.2022 "Për një shtesë në vendimin nr. 201, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në bashkitë Durrës dhe Kamzë", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.44, datë 31.03.2021 "Për detajimin e fondit prej 835,060,995 lekë të përfituar në formën e transfertës së pakushtëzuar nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit", si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit, për vitin 2022, me vlerë 100'000'000 (njëqind milion) lekë pa tvsh, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 291, datë

11.5.2022 “Për një shtesë në Vendimin nr. 201, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në bashkitë Durrës dhe Kamzë”, për objektet sipas tabelës së pikës 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.44, datë 31.03.2021 “Për detajimin e fondit prej 835,060,995 lekë të përfituar në formën e transfertës së pakushtëzuar nga Fondi i Rindërtimit i buxhetit të shtetit”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike, Bashkia Durrës.


Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 01.06.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 474 prot.
9

Durrës, më 07.06.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS

KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.52 datë 31.05.2022 “Për miratimin e përdorimit të fondit të rindërtimit për vitin 2022 me vlerë 100’000’000 lekë pa tvsh, në zbatim të VKM nr. 291, datë 11.5.2022 për një shtesë në VKM nr.201 datë 25.3.2021, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) në Bashkitë Durrës dhe Kamzë”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

